



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Republika e Kosovës Republika Kosovo - Republic of Kosovo Autoriteti i Konkurrencës Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority
Nr. i Prot./Uk. Prot./Uk. No. 808/24-11/D
Nr. i Uj./Ur. Sl./No. Pq. 1/4
Data/Datum/Datë: 17.12.2024
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Vendimi Nr.106/24
Datë: 17.12.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023 Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkates. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, në mbledhjen e datës 17.12.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. Lejohet, Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e drejtpërdrejt të Private Joint Stock Company "SAV92"(blerësi) prej 100% te aksioneve mbi Orbico Ukraine L.L.C., (targeti) dhe Orbico d.o.o (shitësi).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 29.10.2024, me Nr. Prot. 706/24-01/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me blerjen e aksioneve nga Private Joint Stock Company SAV 92 (blerësi) mbi Orbico Ukraine L.L.C., dhe Orbico d.o.o (shitësi).

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë: 18.11.2024
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me: datë 19.11.2024
3. Palët kane nënshkruar kontratën mbi shitblerjen e pasurive të paluajtshme me datën 27 Tetor 2023

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë është 20,000,000 Euro.

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë është 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
3. Marrëveshja e nënshkruar me datë 27 Tetor 2023, ndërmjet Kompanisë private aksionare “Asnova Holding” dhe Orbico d.o.o dhe kompania private aksionare “SAV 92”

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, i paraqitur në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe bazuar në nenet 11,13,16,17,18 si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2023 neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve Sekretariati ka filluar vlerësimin e kërkesës për Përqendrim.

Palët në transaksion:

Private Joint Stock Company” SAV 92”, (blerës), është shoqëri aksionare e regjistruar me numër të regjistrimit të biznesit: 42903398, Adresa: 27 Mykola Krasnova Street 03115 Kyiv, Ukraine. Blerësi është ndërmarrje e përbashkët e themeluar mes Orbico d.o.o., e cila mbanë 51% të aksioneve dhe Asnova Holding e cila ka 49% të aksioneve, e cila zotëron të drejtën e vetos mbi vendimet thelbësore për aktivitetet strategjike ekonomike të Blerësit të cilat së bashku ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi SAV 92.

Orbico Ukrainë L.L.C., (targeti), është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar me numër të biznesit: 40045487, me Adresë: 2Heorhiia Toropovskoho Street, 02100 Kyiv, Ukraine. Ndërmarrja është në pronësi të Orbico d.o.o. Aktiviteti i shoqërisë: Shitje me shumicë e parfumeve dhe kozmetikës.

Orbico, d.o.o., (shitës), është kompani kroate me selinë e saj të regjistruar në Koturaska Cesta 69, Zagreb; HR-1000, Kroaci dhe e regjistruar në Regjistrin Gjyqësor me numrin 080234144. Orbico është një kompani mbajtëse e Grupit Orbico, së ciles i janë bashkangjitur të gjitha kompanitë e lidhura me Orbico në mënyrë direkte ose indirekte. Grupi Orbico është distributor i një numëri të madh markash të ndryshme duke filluar nga produktet e kujdesit të bukurisë përmes produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, pajisjeve teknike dhe elektrike deri të produktet farmaceutike, lodrat, tekstilet, cigaret si dhe produktet e vajit motorike. Në tregun e Republikës së Kosovës Orbico është mbajtës i 51 % të aksioneve në kompaninë në Orbico Shpk Kosovë, e cila është një kompani me përgjegjësi të kufizuar me numër unik identifikimi 810501800 e angazhuar në tregjet e mallrave të konsumit me lëvizje të shpejtë (FMCG) dhe Beauty (“Orbico Kosova”). SAV 92 dhe Asnova nuk operojnë dhe për këtë arsye nuk gjenerojnë asnjë qarkullim në Kosovë

Asnova Holding, është një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Ukrainës , me numër të biznesit 32252776, me Adresë: 27 Hetmana Kyryla Rozumovskoho Street, Kiev, 03115, Ukraine. Asnova Holding, ushtron kontroll të përbashkët mbi Sav 92 së bashku me Orbico d.o.o.

Tregu përkatës;

Tregu i produktit, Tregu i shitjeve me shumicë i parfumeve dhe kozmetikës dhe (FMCG për mallrat e konsumit me lëvizje të shpejtë.

Tregu përkatës gjeografik, në transaksionin e propozuar përkufizohet si treg ndërkombëtar duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës.

Analiza e konkurrencës:

Transaksioni i propozuar nuk paraqet shqetësim për çështje të konkurrencës në tregun e Republikës së Kosovës, pasi që, tregu i produkteve ku palët e përfshira në transaksion operojnë, është treg shumë konkurrues duke përfshirë një laramani të madhe të produkteve dhe brendeve të ndryshme. Sa i përket tregut ku Orbico Kosova është i angazhuar në menyre aktive si në tregun e mallrave të konsumit me levizje të shpejtë ashtu edhe në atë të Bukurisë, duke zbatuar nje strategji inovative në keta sektorë i cili fokusohet në mënyre specifike në segmentin e Ushqimit, me një theks të dukshëm në drithërat dhe ushqimet tjera. Për me tepër Orbico Kosova merr pjese edhe në tregun jo-ushqimor, veçanërisht në bateri. Orbico Kosova luan një rol të rëndësishëm edhe në tregun e bukurisë, duke u fokusuar në kozmetik, parfume dhe produkte make-up të nivelit të lartë. Blerësi synon që përmes këtij transaksioni të zgjerohet me tej në kategorite e tjera të produkteve dhe kanaleve të shitjeve në tregun e Ukraines ku Orbico Group ka qenë tashmë i pranishem si Distributor për produkte kozmetike dhe për kujdesin e flokeve që nga viti 2015 permes filialit të tij Orbico Ukrainë L.L.C. Ukraina është treg shumë i fragmentuar me një sasi të madhe dyqanesh të vogla, të pavarura pranë tregtisë moderne të organizuar nëpër dyqanet në Ukrainë. Prania e Orbico mund të jetë me vlerë e shtuar duke filluar me Orbico si një burim tjetër produkti dhe shërbimi, me listen aktuale të produkteve dhe disponueshmerinë e tyre dhe deri në portofolin e ti që Orbico mund të sjellë në Ukrainë, me përvojën e tij edhe në tregje te tjera.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Arsyeja e kërkesës për Përqendrim pranë Autoritetit është bërë sepse në tregun e Republikës së Kosovës Orbico d.o.o., është mbajtes i 51 % të aksioneve në kompaninë Orbico Shpk Kosovë. Duke marrë parasysh që SAV 92 dhe Asnova Holding nuk operojnë në asnjë formë në Kosovë. Transaksioni nuk do te qojë në ndonjë mbivendosje horizontale në Kosovë pasi nuk ka mbivendosje konkurruese horizontale ndërmjet kompanive të portofolit të kontrolluara nga Orbico dhe SAV 92 në Kosovë. Nuk ka marrëdhënie vertikale ndërmjet kompanive të portofolit të kontrolluara nga Orbico dhe SAV 92, në Kosovë dhe kombinimi i aktiviteteve nuk do të çojë në një pozicion dominues në treg për asnjë nga linjat e produkteve të përfshira. Transaksioni si i tillë nuk do ndikojë në tregun e Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës, transaksioni i propozuar nuk mund të forcoj asnjë pozitë dominues në treg, andaj, tregu i Kosovës mbetet i pandikuar nga ky transaksion.

Autoriteti, me marrjen e njoftimit të plotë të përqendrimit, në përputhje me nenin 17 paragrafi 3 në paragrafi 3.4, ka publikuar në ueb faqen e vet njoftimin publik, për përqendrimin e synuar, i cili është obliguar të qëndroj 15 ditë, (<https://ak.rks-gov.net>), lidhur me parashtrimin e vërejtjeve, komenteve, në mënyrë që të dhënat e mbledhura të kontribuojnë në sqarimin, pra në kuptim, të marrëdhënies dhe situatës në tregjet përkatëse. Autoriteti, nuk ka pranuar asnjë reagim, nga palët e interesuara.

Shënim:


Çdo formë e shtrebbërimin të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva